



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec



	REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC	
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET		
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)		
Nr./Br./No 6403 Nr. i faq/Br.str/No.pg 143		
Data/Datum/Date 11 / 8 / 25		
RAHOVEC / ORAHOVAC		

**Procesverbal i dëgjimeve buxhetore për
përgatitjen e buxhetit për vitin 2026,
me fokus fshatrat Krushë e Madhe, Nagac, Hoçë e Vogël,
Brestoc, Celinë**

INFORMATË RRETH NJOFTIMEVE

Njoftimi për organizimin e dëgjimeve buxhetore për përgatitjen e buxhetit për vitin 2026, me banorët e Rahovecit, me fokus fshatrat Krushë e Madhe, Nagac, Hoçë e Vogël, Brestoc, Celinë, u publikua me datë: 21.7.2025 në ueb faqen e komunës së Rahovecit, në këtë vegëz: <https://rahovec.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/07/Njoftim-per-mbajtjen-e-degjimit-publik-per-buxhetin-e-vitit-2026-Krushe-e-Madhe-1.pdf> në harmoni me afatet ligjore që i përcakton Udhëzimi Administrativ, si vijon:

Duke u bazuar në Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005, si dhe nenit 31 të Udhëzimit Administrativ MAPL Nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa në bashkëpunim me Zyrën për Informim nga data: 21.07.2025 deri me datë: 04.08.2025 do të organizohen gjashtëmbëdhjetë (16) dëgjime publike buxhetore.

Me qëllim të rritjes së nivelit të transparencës e llogaridhënies dhe për t'i mbajtur sa më të informuar banorët e komunës së Rahovecit, rreth orarit dhe vendit të mbajtjes së dëgjimeve buxhetore, janë bërë me kohë planifikimet dhe është publikuar me kohë kalendari i dëgjimeve buxhetore për gjashtëmbëdhjetë (16) dëgjimet buxhetore në komunën e Rahovecit në këtë vegëz: <https://rahovec.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/07/Kalendari-i-degjimeve-buxhetore-publike-me-qytetare-per-buxhetin-e-vitit-2026.pdf> më datë: 07.07.2025.

Po ashtu, bazuar në afatet ligjore janë njoftuar *kryetarët e fshatrave dhe lagjeve urbane*, ku janë janë të informuar rreth mbajtjes së dëgjimeve me anë të publikimit të secilit njoftim veç e veç, për secilin vendbanim, në ueb faqe të komunës, shtatë ditë para mbajtjes së dëgjimit.

Njoftimi për mbajtjen e dëgjimit buxhetor me banorët fshatrave Krushë e Madhe, Nagac, Hoçë e Vogël, Brestoc, Celinë, u publikua më datë 29.07.2025 në këtë vegëz:

[U MBAJT DËGJIMI BUXHETOR NË KRUSHË TË... - Komuna e Rahovecit | Facebook](#) Njoftimet përveç që janë publikuar në uebfaqe të komunës, në Platformën për Konsultime Publike, në rrjetin social Facebook, njoftimet u janë dërguar edhe kryetarëve të këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane përmes rrjeteve sociale Viber dhe WhatsApp.

DËGJIMI PUBLIK ME BANORËT E FSHATRAVE KRUSHË E MADHE, NAGAC, HOÇË E VOGËL, BRESTOC, CELINË

Dëgjimi buxhetor me **banorët e fshatrave Krushë e Madhe, Nagac, Hoçë e Vogël, Brestoc, Celinë**, që veprojnë në komunën e Rahovecit u mbajtë më: 29.07.2025 te **Amfiteatri i muzeut “Ukshin Hoti”**, me fillim në ora **19:00**.

Qytetarë pjesëmarrës gjithsej të pranishëm ishin: 15

- Femra ishin: 2
- Meshkuj ishin: 13

Dëshmi janë listat nënshkruese të pjesëmarrësve në këtë dëgjim.

Të pranishëm: Drejtori i financave, Afrim Limani, zyrtarët e Drejtorisë së Financave dhe anëtarët e grupit punues për buxhet.

Takimin e hapi shefi i Kabinetit të Kryetarit **z. Ardit Halilaj**, ku i dëshirojë mirëseardhje të gjithë të pranishmëve. Për më shumë rreth buxhetit të vitit 2026, fjalën e ka drejtori për buxhet dhe financa **z. Afrim Limani**, dhe më pas qytetarët e fshatrave pjesëmarrëse.

Afrim Limani, drejtor për Buxhet dhe financa: Të nderuar të pranishëm, përshëndetje për të gjithë! Më 15 maj 2025 ka ardhur qarkorja e parë buxhetore financiare që përcakton kufijtë dhe tavanet buxhetore për buxhetin e Komunës së Rahovecit. Sipas qarkores së parë buxhetore, buxheti i Komunës së Rahovecit në total, duke përfshirë edhe të hyrat vetanake do të jetë 21,547,732€. Nëse bëjmë krahasim me vitin 2025, atëherë është një rritje e buxhetit prej 564,936€, duke përfshirë edhe të hyrat vetanake. Ne e presim edhe qarkoren e dytë buxhetore, e cila është dashur të vijë në muajin korrik, por ende nuk na ka ardhur ka vonesa nga ministria e financave, kjo qarkore pastaj do ti caktojë qartë të gjitha pozicionet buxhetore edhe pse ne mendojmë që nuk do të ketë shumë ndryshime nga qarkorja e parë. Granti i administratës është 9,168,059€, që është i njëjtë me vitin e kaluar. Granti i arsimit është 7,504,301€, në krahasim me vitin 2025 ka rritje prej 174,145€. Granti i shëndetësisë: 2,360,221, që në krahasim me vitin 2025 ka një zbritje prej 91,979€. Në total, buxheti është 21,547,732€. Buxheti në kategori ekonomike përafërsisht do të jetë kështu: Pozicioni i pagave do të jetë 12,499,116, në krahasim me vitin 2025 kemi një rritje prej 1,752,667€. Mallra dhe shërbime mbesin të njëjta 2,761,006. Komunalit mbesin të njëjta prej 390,000. Subvencione kemi 1,000,000 dhe ka një zbritje prej 10,000€. Investimet kapitale 4,897,610 dhe që kanë një zbritje prej 1,177,731€. Gjithashtu paraqiti edhe dy faktor kryesor që do të ndikojnë në problemet financiare në këtë vit për komunën tonë: Kontrata Kolektive si dhe numri i ulët i popullsisë për komunën e Rahovecit të bërë nga regjistrimi i fundit i përfunduar në vitin 2024, prandaj këta dy faktor kanë ndikuar që të kemi një zbritje


sidomos te pozicioni i Investimeve Kapitale. Ky është në total buxheti i Komunës së Rahovecit, për vitin 2026. Në dorë keni edhe një dokument, që sipas programeve dhe kategorive ekonomike ta dini shpërndarjen e buxhetit.

Nr.	Emrat	Propozimi – kërkesa	Vlerësimi i komunitetit
	Emri i personit që propozon	Përshkrim i shkurtër i propozimit	A ka pasur pajtim nga të pranishmit për këtë propozim
1.	Afrim Dina, Celinë	Si përcaktohet granti për këshillin e Hoçës së Madhe nga ministria?	
2.	Sejfullah Sejfullahu, Krushë e Madhe	Raportimi mbi punën e këshillit të Hoçës së Madhe në kuvendin komunal?	
3.	Muhamet Ramadani, përfaqësues i këshillit të fshatit Celinë	Të jenë me prioritet investimet në bujqësi sidomos në rrugët fushore?	
4.	Muhamet Ramadani, përfaqësues i këshillit të fshatit Celinë	Shtrimi i rrugëve me kubëza?	
5.	Valmir Gashi, Nagac	Shtrimi i rrugëve me kubëza, dhe rregullimi i rrugëve fushore?	
6.	Valmir Gashi, Nagac	Mirëmbajtja e kanalizimit në fshat?	
7.	Valmir Gashi, Nagac	Shtrati i lumit brenda në fshat në cilën fazë është?	
8.	Valmir Gashi, Nagac	Rrethimi i fushës sportive në Nagac?	
9.	Selami Hoti, përfaqësues i këshillit të fshatit Krushë e Madhe	Mirëmbajtja e kanalizimit?	
10.	Selami Hoti, përfaqësues i këshillit të fshatit Krushë e Madhe	Mirëmbajtja e ndriçimit publik në fshat?	
11.	Selami Hoti, përfaqësues i këshillit të fshatit Krushë e Madhe	Shtrimi i rrugëve me kubëza brenda në fshat?	
12.	Selami Hoti, përfaqësues i këshillit të fshatit Krushë e Madhe	Rrjet i ri i kanalizimit në disa lagje?	
13.	Selami Hoti, përfaqësues i këshillit të fshatit Krushë e Madhe	Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve në fshat?	




14.	Selami Hoti, përfaqësues i këshillit të fshatit Krushë e Madhe	Çka po ndodh me rrugën që shkon nga Drini?	
15.	Selami Hoti, përfaqësues i këshillit të fshatit Krushë e Madhe	Furnizimi me pelet në shkollën fillore dhe të mesme të ulët a do të jetë në kohë?	
16.	Selami Hoti, përfaqësues i këshillit të fshatit Krushë e Madhe	Shtrimi i rrugës me asfalt Krushë - Nagac - Retijë nga vreshtat?	
17.	Selami Hoti, përfaqësues i këshillit të fshatit Krushë e Madhe	Mirëmbajtja e Muzeut?	
18.	Selami Hoti, përfaqësues i këshillit të fshatit Krushë e Madhe	Rruga në mes Krushës dhe Celinës në cilën fazë është?	
19.	Selami Hoti, përfaqësues i këshillit të fshatit Krushë e Madhe	Palestra sportive në fshat?	
20.	Selami Hoti, përfaqësues i këshillit të fshatit Krushë e Madhe	Të vendosën kamera të sigurisë në fshat?	
21.	Avdurrahman Duraku, Krushë e Madhe	Rregullimi i rrugës që shkon ka Drini?	
22.	Avdurrahman Duraku, Krushë e Madhe	Të bëhet presion "KRU GJAKOVA" për pastrimin dhe mirëmbajtjen e kanalizimit?	
23.	Blerim Shala, Krushë e Madhe	Funksionalizimi i kamerave të Amfiteatri i muzeut "Ukshin Hoti"?	
24.	Blerim Shala, Krushë e Madhe	Furnizimi me pajisje për mirëmbajtjen në Amfiteatrin e muzeut "Ukshin Hoti"?	
25.	Besim Hoti, Krushë e Madhe	Rregullimi i rrugës dhe kanalizimit të shtëpia e dëshmorit Halim Hoti?	

Afrim Limani, drejtor për Buxhet dhe financa: Në mungesë të kryetarit të komunës z. Smajl Latifi, pas paraqitjes së kërkesave të juaja nuk po zgjatemi për debat sonte, por të gjitha këto kërkesa të paraqitura nga ana e juaj janë të shënuara në procesverbal dhe së bashku me drejtorët e drejtorive përkatëse, dhe grupin punues për buxhet, do t'i trajtojmë me seriozitet sidomos kërkesat më prioritare dhe të nevojshme për banorët e fshatrave pjesëmarrëse. Me theks të veçantë trajtimin e kanalizimeve si dhe shtrimin e rrugëve fushore dhe me kubëza.

Ju faleminderit për pjesëmarrje, shihemi në takimet e radhës!







Procesmbajtësi:

Egzon Thaqi

Egzon Thaqi



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec



Lista e nënshkrimeve nga dëgjimet publike buxhetore me qytetarët e Rahovecit, me fokus banorët e fshatrave Krushë e Madhe, Nagac, Hoçë e Vogël, Brestoc, Celinë

Nr	Emri	Mbiemri	Vendi	Nr. telefonit	Nënshkrimi
1.	Muhamet	Pamodari	Celinë		
2.	Afin	Dina	Celinë		
3.	Feluni	Dina	Celinë		
4.	Dajina	Gashi	Nagac		
5.	VALMIR	GASHI	NAGAC		
6.	KEBI	ELSHANI	NAGAC		
7.	Fedrit	Gashi	Nagac		
8.	Berret	Durden	K. Madhe		
9.	Sesjullu	Sesjullu	K. MADHE		
10.	AGROP	DINA	K. MADHE		
11.	BERAT	HOTI	K. Madhe		
12.	ALBAN	GASHI	K. MADHE		
13.	GYOGIM	HOTI	K. MADHE		
14.	AGRESA	RAHAPANI	CELINE		
15.	IRPON	RAHAPANI	K. Madhe		
16.					
17.					
18.					
19.					
20.					

Vërejtje: Me nënshkrimin tim në listën e komunës, unë, konfirmoj se komuna mund të përdorë kontaktet e ofruara nga ana ime për të më dërguar njoftime periodike për ngjarje të cilat janë në interes publik. Me nënshkrimin tim, konfirmoj se autoritetet e komunës mund të regjistrojnë takimin për qëllime të procesverbalit dhe të publikimit të fotografive dhe video materialeve promovuese nga këto takime.

Më 29.7.2025, Amfiteatri i muzeut "Ukshin Hoti"